



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-30977/22
Kaçanik, 30.11.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **XI (njëmbëdhjetë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2022 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 30 nëntor 2022. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 25 anëtarë, ndërkohë pas pikës së parë, arriti Betim Shala, kështu që pjesëmarrës të kësaj mbledhje ishin 26. Mungoj me arsye, Arta Avdiu.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës- Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Sali Malsiu-DSHMS, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Dardana Tafili-Dauti- DAP, ndërkaq nga zyrtarët e komunës në kuadër të detyrave të punës ishin: Fatlume Guri-Selimi, Bejtulla Dalloshi, Mavije Murseli, pati edhe zyrtarë tjerë që i përcjellën punimet e seancës (2).

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Gëzim Sahiti- zyrtar i lartë për monitorim të komunave në MAPL.

Mbledhjen e kryesoi, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu.

Kryesuesi i Kuvendit z. Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj pjesëmarrjen, 26 janë prezentë, me arsye mungon Arta Avdiu.

Fillimisht iu njoftoj se është punuar në incizimin e mbledhjeve drejtpërdrejtë të KK. Incizimi i mbledhjes së sotme është sot testuese, se është hera e parë që incizohet një mbledhje drejtpërdrejtë e KK, ndërkaq sesi do të funksionoj nuk e di.

Kushte pune për mbajtjen e mbledhjes kemi, e hapi mbledhjen e XI (njëmbëdhjetë) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2022, data 30 nëntor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;
2. Strategjia për Informim dhe Komunikim 2023-2026;
3. Plani i Veprimit për Transparencë 2023-2026;
4. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve sipas buxhetit të vitit 2022;
5. Propozim Vendimi për formimin e Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023;
6. Propozim Vendimi për shpalljen e interesit publik të pjesëve të PK 00431-3 dhe 00431-4 në ZK Duraj, për këmbim me pronën komunale 00430-1 ZK Duraj;
7. Diskutim për aktivitetet kundër dhunës në baza gjinore.

Lidhur me Rendin e propozuar të punës e hapi diskutim, por nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVON

Rendin e punës në përbërje prej 7 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KK u aprovua pa vërejtje me 1 Abstenim -Agim Mani, për shkak se nuk ka qenë pjesë e procesit. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVON

Procesverbalin e mbledhjes së X (dhjetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 26.10.2022 / Lënda: 01Nr. 60/01-27946/22.

Kryesuesi i Kuvendit: Kalojmë në pozicionin e pyetjeve dhe kërkesave:

Pyetje dhe Kërkesa

z. Naim Beça: Ju përshëndet të gjithëve, iu uroj Ditën e Flamurit, festën me të madhe të shqiptarisë. Kam një pyetje dhe disa sqarime tjera.

1. A ka plan urbanistik komuna e Kaçaniku? Nëse nuk ka, atëherë iu tregoni qytetarëve pse nuk ka komuna plan urbanistik ?

2. Zotëri kryetar, drejtorët ndoshta të kanë thënë se i kanë rregulluar dritat, kanalizimet, por kjo nuk është e vërtetë, për shkak se gjatë të reshurave atmosferike, gypat e kanalizimeve nuk kanë funksionuar në rrugën “Emin Duraku” dhe të Stacioni i trenit. Duhet drejtoritë të dalin në terren të shikojnë gjendjen, në atë pjesë së nuk ka as drita. janë projekte të thjeshta, por të ne ende nuk funksionojnë. Kërkoj të merren veprime të nevojshme nga organet relevante, sepse me mirë ka qenë gjendja me herët kur rruga ka qenë e pashtruar se tani, sepse uji gjatë të reshurave atmosferike qarkullon nëpër rrugë.

znj. Florina Lika-Vishi: Gjetja e forcës për t’u përballur me vështirësi është bërë pothuajse mekanizëm i domosdoshëm i mbijetesës për nënat vetushqyese. Prindërit kanë përgjegjësi të kujdesen për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre, duke ju ofruar një jetesë me të dinjitetshme. Ky parim mbrohet edhe me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe ato të fëmijëve. Megjithatë me shtimin e numrit të shkurorëzimeve dhe ndarjeve si dhe duke mos përjashtuar edhe vdekjen e njërit prind, familjet me një prind (familjet në të cilat fëmijët rriten vetëm nga një prind) janë tashme të zakonshme në shumë vende. Nën timer vetushqyese me fëmijë kanë më shumë gjasa që të përballen me kushte sfiduese socio-ekonomike. Për shembull, nënat vetushqyese kanë më shumë probabilitet që të jenë në gjendje të rëndë ekonomike në krahasim me nënat që jetojnë me një partner apo në krahasim me një baba vetushqyese.

1. Unë kam një kërkesë që do të thotë kërkoj nga ju i nderuar kryetar Besim Ilazi, që të gjitha nënat vetushqyese të komunës së Kaçanikut të lirohen nga pagesa për “fëmijët që dërgojnë në çerdhe publike”.

2. Një propozim tjetër kam që për vitin 2023, sipas mundësive buxhetore, kryetari i komunës të parashihet blerja e një “Mamografi”, ose në të kundërtën të mbulojë shpenzimet e të gjitha grave të komunës sonë që duan ta bëjnë mamografinë.

Kërkesë Drejtorisë Komunale për Kulture Rini dhe Sport

3. Kërkoj nga ju që të rinjve t'iu ofrohet alternativë dhe hapësirë për ti zhvilluar aktivitetet e ndryshme sportive:

3.1 Te parku i qytetit, hapësira me zhavorr hapësirë tashmë e pa shfrytëzuar nga fëmijët kërkoj nga ju që të mund të realizohet një projekt që të ndërtohet një terren sportiv një mini " Fushë basketbolli", ku hapësira e parkut është e përshtatshme për familjarë natyrisht dhe fëmijët do të mund ta kalojnë kohën, por edhe të merren me aktivitete sportive e rekreative.

3.2 Një kërkesë tjetër paraqes për fëmijët e fshatit Dubravë, të cilët aktivitetin e tyre në futboll e ushtrojnë çdo ditë në një fushë të inprovizuar nga vet fëmijët e atyre lagjeve, ku në atë hapësirë frekuentojnë shumë fëmijë duke përfshirë lagjet: Hajdari, Qorri, Kasa dhe një pjesë e lagjes Vishi.

Andaj kërkoj nga ju që të bëhet realizimi i ndërtimit të një terreni sportiv fushe futbollit për fëmijët e fshatit Dubravë, ku ata do të kenë mundësi dhe kushte më të mira për zhvillimin e talentit të tyre.

Pa infrastrukturën e duhur është e vështirë që misioni i tyre për tu bërë sportist në të ardhmen të përmbushet plotësisht. Duke ia ofruar fëmijëve njërin ndër komponentët kryesorë fushën e futbollit u sigurojmë fëmijëve që të realizojnë ëndrrën e tyre, që të ushtrojnë lojën më të bukur në botë, futbollin. Është detyra jonë dhe e kemi për obligim që t'u krijojmë kushte sa më të mira fëmijëve për të qenë sa me të shëndetshëm.

4. Një kërkesë tjetër kam edhe për bibliotekën e qytetit. Kërkoj që të financohet dhe të pasurohet me ekzemplarë të rinj. Të pasurohet me vepra letrare te reja biblioteka e qytetit tonë, duke mundësuar kështu rritjen e fondit librar dhe pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj, njëkohësisht duke i shërbyer kështu edhe lexuesve për pasurimin dhe zgjerimin e dijeve të tyre. Kjo do të ndikonte edhe në rritjen e antarësisë së saj. Duke disponuar sa me shumë material të ri biblioteka, aq më shumë lexues do të tërheq pranë saj. Qëllimi është që të kontribuojmë sado pak në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e leximit duke ndikuar kështu në nxitjen e fëmijëve në lexim dhe avancim të më tejshëm.

z. Agim Mani: Pyetje për kryetarin e komunës-Besim Ilazi, lidhur me projektin e grumbullimit dhe furnizimit të ujit në rrjetin sekondar që do të zgjidhte problemin e ujit në shumë lokalitete, projektin me madhor që kushton mbi 1 milion euro, i financuar nga ministria, që është realizuar në komunën tonë gjatë mandatit të juaj kryetar. Edhe pse kanë kaluar shumë vite, ky projekt, nuk është përfunduar. Pyetja: Në cilën fazë është projekti dhe a keni arritur që këtë projekt të shfrytëzoni maksimalisht apo fare hiq, kur dihet se ky investim është mirëpritur nga qytetarët e komunës dhe ka qenë projekt shumë i nevojshëm me zgjidhë problemin e ujit në disa lokalitete dhe ka qenë investim i ministrisë për me zgjidhur këtë problem parësor qenësor. A keni arritur me bërë funksional dhe sa ka ndikuar që ky projekt me shtuar kapacitetin e ujit dhe sa është shtuar kapaciteti i ujit dhe a keni kërkuar ndonjëherë raport nga dikasteri përkatës lidhur me këtë projekt sesa është shtuar kapaciteti i ujit ?

z. Bashkim Luma: Arsyet që unë sot para jush po e marr fjalën janë të ndryshme, duke filluar nga ndriçimi publik në fshatin Glloboçicë, ku përveçse i parcializuar edhe pse tashmë bëhet një vit që nga fillimi i saj, tashmë si projekt është jo efikas sepse afërsisht 50 % e këtij gjysmë projekti ka kohë që nuk është funksional, arsyeja pse nuk është funksional duhet që të na tregoj drejtori përgjegjës për këto çështje. Përveç kësaj kërkoj që në emailin zyrtar të më dërgohet ky gjysmë-projekt i ndriçimit publik, por edhe projekti për renovimin e rrjetit të kanalizimit, si dhe projektin e ujësjellësit po ashtu të lënë në gjysmë, pra bëhet fjalë për projekte të fshatit Glloboçicë, sepse mendoj që banorët e asaj pjese kanë nevojë të dinë më shumë për të vërtetat e secilit projekt! Dhe tjetra që po ashtu është shumë me rëndësi, ka të bëjë me kompaninë "KRM- Pastërtia" mua si komisionar i kësaj kompanie, së fundi më është dërguar një email nga ish kryesuesi i bordit të drejtorëve të kësaj kompanie z. Skender Hyseni, po e ritheksoj ish kryesues sepse tashmë personi në fjalë është shkarkuar nga pozita e bordit të drejtorëve.

Indikacionet sipas tij janë shkaku që ai ka paraqitur pakënaqësitë e tij në keq menaxhimin e kompanisë. Sipas raportit 6 mujorë të këtij viti kjo kompani ka performuar me bilanc negativ, ashtu që inkasimi apo te hyrat e mbledhura janë më të vogla për 96,876.63€ sesa shpenzimet, (pra kemi një humbje prej afro 100 mijë €). Numër i madh i te punësuarve vetëm në këtë 6 mujor është afro 40 persona (e shumica në administratë). Besoj që ekzekutivi është i informuar për këtë humbje të madhe në kompaninë që edhe është komunale, por ne si kuvend ende s'kemi ndonjë sqarim lidhje me këtë situatë që me shumë të drejtë do ta quaja gjakderdhje financiare, andaj pa humbur kohë kërkoj nga ekzekutivi që të sqarohen për këto humbje kaq të mëdha të kompanisë për vetëm për 6 muaj.

z. Agim Çaka: Po e ngriti një çështja e zërimit të cilën e kam marrë përgjigjen, ku përpos gabimeve teknike, është e pakuptueshme përgjigja. Ne e kemi potencuar në mbledhje të KK se po bëjmë shpenzime të shumta në komunë për zërim, e potencuam se janë ndarë 19.000€, por nuk e dija për sa kohë dhe nga përgjigja e kuptova se janë ndarë për 3 vite, 2019-2022. Vlera që e ka paraparë komuna me u ndarë për zërim ka qenë 19.000€. Shuma e mjeteve nuk është e planifikuar mirë, sepse mundem me gabuar për një shumë të vogël, e jo për një shumë kaq të madhe, sepse afër 50% e mjeteve të ndara nuk janë shpenzuar. Gjithashtu ka diskrepancë mes viteve për mjetet e shpenzuara, kur e dimë se vitet 2019, 2020 ka qenë piku i pandemisë dhe nuk ka pasur aktivitete aq shumë me qenë kjo diferencë e mjeteve. Komuna duhet me menduar që çështjen e zërimit me i blerë pajisjet e zërimit, të cilat pajisje kishin me qëndruar në shtëpinë e kulturës, sepse të gjitha mjetet janë për aktivitete në shtëpinë e kulturës, ndërkaq pak aktivitete ka në terren, ndërkaq çështjen e menaxhimit të zërimit mundemi me diskutuar në të ardhmen. Problem tjetër është, organizimi i festave, sidomos festën e flamurit dhe festat e nëntorit, duhet me pasur një organizim me të madh me unik, me kompakt, e jo të zbehtë, sepse të shtëpia Muze e dëshmorit Ismail Raka, simboli i UÇK dhe të kulla e Hasanit dhe f. Nikaj, ka pasur një mos unitet të kolegëve këtu që i kemi, se në këto festa është mirë me qenë me unik me të bashkuar, me pasur organizime të përbashkëta pa marrë parasysh ndasive politike, se ne duhet me u treguar para qytetarëve se në raste të caktuara dimë me u bërë bashkë.

z. Adnan Reka: Unë kam një replikë për z. Agim Çaka: Ne si subjekte politike, përfaqësojmë subjektet tona politike, megjithatë nuk është me i vogël respekti nëse ne nuk shkojmë bashkë me pozitën me i nderuar luftëtarët e rënë për liri. Ne e kemi subjektin tonë politik dhe përfaqësojmë subjektin tonë dhe shkojmë ashtu si duam ne.

z. Agim Çaka: Unë nuk potencova ndonjë subjekt politik të caktuar, vërejtja ishte të komuna. Unë e theksova: A ka mundësi ndonjë angazhim me i madh i komunës që se paku në festa të caktuara të jemi bashkë. Nuk ishte problemi sesi ka shkuar LVV, se ne mundem edhe individualisht me bërë vizita të tilla, por mendova se nuk është mirë për syrin e qytetarëve me shkuar ndaras, sidomos në festa të caktuara.

Kryesuesi i Kuvendit: Organizimi i festës ka qenë publike, dhe askush nuk mundet me obliguar askënd me marrë pjesë në ndonjë organizim kur ai nuk e ka vullnetin dhe që donë me festuar në ndonjë mënyrë tjetër. Mirë është me qenë bashkë, por ka dikush që mendon ndryshe dhe është e natyrshme që donë me festuar vet në mënyrën e vet. Ftesa ka qenë publike në faqe zyrtare dhe rrjetet sociale se bashku me agjendën, kështu që është në vullnetin dhe dëshirën e secilit se a merr pjesë apo jo.

z. Adnan Reka: Unë nuk të di qëllimin se çka ke dashur me thënë z. Agim, u thashë atë që e potencova, nëse ke dyshime mundesh me kthyer incizimin.

Kryetari i Komunës – Besim Ilazi: E potencoj edhe kryesuesi, megjithatë po e ndiej obligim me i dhënë dy tri fjalë. Unë jam kryetar i komunës nga një parti politike, por i përfaqësojë të gjithë qytetarët e komunës së Kaçanikut. Njoftimet për këtë festë shumë të rëndësishme janë

bërë publike në faqen zyrtare të komunës dhe e njëjta iu ka përcjellë anëtarëve të KK. Pajtohem me juve që ka qenë i zbehtë organizimi, por këto kanë qenë mundësitë tona, se ka pasur mundësi me qenë pak me i pasuruar. Partitë politike janë, por institucionet duhet me u respektuar nga të gjithë. Me duket jo në rregull kur institucioni del me një orar të caktuar, ndërkaq partitë politike fillojnë me orare tjera. Ne jemi munduar me respektuar atë që na takon si institucion.

z. Agim Çaka: Nuk është Adnan çështja se bëra gabim në shprehje, çështja është se si fenomen nuk është në rregull, se ekziston mundësia që dikush nuk ka mundësi me ardhur fare, por problemi është të lëmë një kulturë tek gjeneratat e reja -një frymë uniteti. Organizimet, festat duhet me i bërë bashkë e me përcjellë tek gjeneratat e reja një frymë uniteti. Mendoj se duhet lënë anash problemet në festa të tilla e të bëhemi bashkë me festuar, se mos uniteti edhe në bisedime mund të ndikoj jo mirë.

z. Bashkim Krasniqi: Shprehi shqetësim lidhur me punëtorët të cilët punojnë në Ferizaj, se kanë mungesë transport deri të Fusha e Pajtit. Kërkoj të shqyrtohet mundësia që se paku në mëngjes të sigurohet transport, sepse ka edhe nxënës që mësojnë në Ferizaj dhe transporti paraqet problem për ta, sepse po duhet me bërë shumë kilometra në këmbë deri të Fusha e Pajtit.

2. Shqetësim tjetër; Nxënësit e shkollës fillore që po transportohen me minibus, pagesa mujore është 12€. Kërkoj të shqyrtohen mundësitë për ato familje që kanë 2-3 nxënës për subvencionimin e shpenzimeve të transportit, sepse pagesa mujore është bukur e madhe për ato familje.

z. Naim Beça: Në kohën e fundit është folur në TV publike dhe ato private për çështjen e shkollës fillore “Emin Duraku” e Kaçanikut. Sadopak kemi biseduar me disa anëtarë të këtij kuvendi, ndërkaq informatat të cilat i kam marrë se fundi është se, Komuna e Kaçanikut e ka bërë planin për këtë shkollë. Për këtë çështje është folur edhe në Kuvendin e Kosovës se Komuna e Kaçanikut e ka këtë shkollë shumë të vjetër. A ka dërguar komuna vlerësimin për rindërtimin e shkollës ? Nëse ka mundësi, ai vlerësim të na dërgohet edhe neve anëtarëve të KK. nëse është ashtu siç ka thënë deputetja, të përcjellim vlerësimin për shkollën dhe të ndërtohet shkolla e re.

Kryetari i Komunës – Besim Ilazi: Ne në vazhdimësi nga viti 2018 e kemi përcjellë kërkesën për këtë shkollë dhe asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje. Përgjigja në kuvend ka qenë befasuese, sepse nuk ekziston asgjë zyrtare që kanë kërkuar nga ne informata lidhur me këtë çështje. Ne, në momentin që kemi dëgjuar përmes mjeteve të informimit, iu kemi përgjigjur deputetes dhe atë përgjigje ua përcjellim edhe juve. Është vlerësimi se ajo shkollë nuk i plotëson më kushtet, tani presim reagimet e nivelit qendror sesi do të jenë.

znj. Ardita Rrahmani: Kam vërejtje për mungesën e kushteve të punës – salla nuk është ngrohur.

Kryesuesi i Kuvendit: Pyetje dhe Kërkesa tjera nuk ka, besoj përgjigjet do t’i merrni nga ekzekutivi i komunës. Kalojmë në shqyrtimin e pikave të rendit të punës:

2 .Strategjia për Informim dhe Komunikim 2023-2026;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Unë ju kisha drejtuar hartuesit të strategjisë që gjatë përpilimit të përdoret një standard, sepse diku shkruan 2022-2025, 2022-2026 apo 2022-2027. Ne dëshirojmë që komuna janë të ketë një Strategji të mirë për komunikim dhe informim në raport me qytetarët. Kjo strategji e rritë transparencën, përveç kësaj qytetari të jetë mirë i informuar dhe të funksionoj me informimin nga ekzekutivi, KK dhe dikastere tjera. Është shqetësuese fakti që në komunën tonë është vetëm 1 zyrtar për informim në kuadër të kabinetit të zyrës së kryetarit dhe ai zyrtar kryen edhe punë tjera, kur dihet se në komunën tonë nuk operon asnjë medie lokale, ndërkaq

raporti i informimit të qytetarëve varet vetëm nga ky zyrtar. Është i pamjaftueshëm të gjitha të gjitha informacionet me iu komunikuar publikut dhe kjo e bënë komunën jo transparente karshi qytetarëve. Në strategji thuhet se, komuna do të krijoj mundësi optimale për ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale, në raste të veçanta do të angazhohen edhe ekspertë nga jashtë, me qëllim të komunikimit dhe informimit të administratës komunale. Nëse komuna ka ngecje, është mirë me angazhuar ekspertë nga jashtë, që qytetarët të kenë informim me të qartë dhe me të shpejtë. Besoj se komuna jonë do të shfrytëzoj edhe këtë mundësi, për me qenë me transparente ndaj qytetarëve. Kjo strategji ka rëndësi të veçantë se krijon ura bashkëpunimi në mes institucionit dhe qytetarit. Komuna thuhet se ka mbajtur dëgjime publike, janë ndjekur të gjitha procedurat, ndërkaq nuk ka procesverbal të atij dëgjimi publik. A mundeni me na dhënë informata të drejtpërdrejtë apo me shkrim, sa ka qenë pjesëmarrja e qytetarëve në dëgjime publike për me kontribuar në këtë strategji ?

znj. Fatlume Guri-Selimi: Siç e diskutuam edhe me herët, në material janë disa gabime teknike. Meqë jemi në përfundim të këtij viti, Strategjia është për 2023-2026, për 4 vite. Këto dokumente janë të përcaktuar nga ministria në obligim ligjor me i miratuar KK. Marrë parasysh zhvillimin e trendëve teknologjike që po bëhen, jemi të obliguar të veprojmë në bazë të kohës, ku përveç rrjeteve sociale jemi të obliguar t'i përshtatemi nevojave të publikut. Të pyetja për dëgjimet publike, është shqetësuese pjesëmarrja e publikut, për kundër obligimeve tona të cilat i kryejmë, ne kemi krijuar formën elektronike, ku i pranojmë emailet e qytetarëve, kjo është një nismë e mirë, ndoshta do të realizojmë edhe në të ardhmen. Raportet e dëgjimeve publike janë të publikuara, numrin e pjesëmarrësve nuk është cekur, janë diku 50-60 qytetarë për krejt dëgjimet publike, prania e qytetarëve është e mirë se edhe dokumenti del më i mirë nëse e merr opinionin e qytetarëve. Për strategjinë nuk ka marrë pjesë asnjë qytetarë. Komuna e ka caktuar zyrtarin për dëgjime publike, jam unë, po mundohemi me i bërë disa ndryshime në këtë drejtim. Ne e kemi UA të ministrisë, pjesë e saj është raporti, pyetjet e qytetarëve dhe përgjigjet nga ekzekutivi, që e bënë qytetarin me u ndier mirë kur e merr përgjigjen me shkrim, pavarësisht çfarë përgjigje merr.

z. Agim Mani: Unë në faqen zyrtare nuk e kam parë së është publikuar procesverbali i dëgjimit publik për këtë strategji.

znj. Fitore Vishi: Materiali i përgatitur për seancën e sotme është mjaftë voluminoz, është edhe përmbajtësor dhe i përgatitur meritueshëm dhe me përgjegjësi profesionale nga hartuesit kompetent të dikastereve përkatëse. Ky Plan veprimi për komunën e Kaçanikut është gjithëpërfshirës, i bazuar në kërkesat dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe në Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje – Konventa e Stambollit. Rreth këtij dokumenti mund të ketë debate të mira dhe konstruktive, por gjeneraliteti i tij është i lidhur domosdo me shtylla tjera të shoqërisë sonë dhe Kaçaniku nuk përbën ndonjë përjashtim nga komunat e tjera të Kosovës. Sensibilizimi i shoqërisë tonë mbi problematikën e dhunës në familje dhe dhunën ndaj grave mund të bëhet edhe përmes udhëzimeve me shkrim, në formë fletushkash, duke i shpërndarë ato nëpër familje, lagje e fshatra, duke organizuar takime me grupe grash e vajzash, me burra e të rinjtë, si formë preventive për vetëdijesimin e komunitetit dhe parandalimin e fenomeneve të dhunës në familje dhe dhunën ndaj grave. Ky dokument është solid për të vepruar në bazë të tij.

znj. Kadrije Lika-Troni: Kam një pyetje: Nga cili vit ka filluar të aplikohet strategjia për komunikim dhe informim apo është për herë të parë ?

znj. Fatlume Guri-Selimi: Strategjia për komunikim dhe informim është duke u aplikuar për herë të parë. Si promovim i komunës e kemi cekur se është, ndarja e drejtorisë për zhvillim dhe turizëm të komunës nga drejtoria për buxhet dhe financa, ku jemi në përfundim të hartave turistike, katalogut të vendeve me potencial të zhvillimit të vendeve që mundën me u vizituar prej qytetarëve të ndryshëm. Ky është një hap i mirë, por nuk mjafton. DZHE ka edhe

planifikime tjera në koordinim me ekzekutivin, disa projekte mund të përfshihen në këtë dokument.

znj. Kadrije Lika-Troni: Arsyeja pse po e bëjë pyetjen është se, kemi hasur data e vite të ndryshme, ajo na ka bërë me u ndier të pasigurt. Pyetje për kryetari, të çështja e promovimit të marketingut, cili ka qenë marketingu i fundit që ia keni bërë komunës tonë dhe në çfarë fushe. Të pika 3. 7, dobësitë aktuale të komunikimit të swot analiza, keni paraqitur dobësi aktuale mungesën e burimeve në zyrën për informim dhe marrëdhënie me publikun. A mund të detajoni pse ka mungesë dhe ku qëndron problemi?

Kryesuesi i Kuvendit: Ne kemi kërkuar nga MAPL që të kemi një zyrtar për informim të veçantë, përgjigja ka qenë negative, kështu që ka mbetur në kuadër të zyrës së informimit me u bërë transparente puna e KK.

z. Adnan Reka: Uroj që këto dokumente të mos mbeten vetëm në letër si zakonisht, por të jenë realitet në të mirë të qytetarëve, të përmbushë kërkesat për qasje në dokumente zyrtare e mos të na zgjasin me vite, siç kanë ndodhur deri me tani, e mos të detyrohemi me iu drejtuar agjencisë, e që pastaj ju të merreni me kërkesat për qasje në dokumente zyrtare.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 25 votë Për, Kundër votë nuk pati, Abstenoj Raif Kasa nga LVV. Pjesëmarrës në votim, 26 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Strategjisë për Informim dhe Komunikim 2023-2026 / Lënda: 01Nr. 104/02-30293/22.

3. Plani i Veprimit për Transparencë 2023-2026;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: A duhet përmirësuar edhe të ky dokument standardi 2023-2026, 2023-2027?

z. Rrustem Zenuni: Me vjen mirë që komuna ka hartuar këto dokumente, që transparenca të rritet. Në këtë plan janë përcaktuar se janë një sërë ligjesh e udhëzime administrative që rregullojnë çështjen e transparencës, që transparenca të jetë në nivel sa më të lartë. Pikërisht angazhimi i komunës dhe organeve tjera relevante ka bërë që komuna e Kaçanikut me vite është vlerësuar për transparencë në bazë të vlerësimit të nivelit qendror.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Pjesëmarrës në votim, 26 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Planit të Veprimit për Transparencë 2023-2026/ Lënda: 01Nr. 104/02-30297/22.

4. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve sipas buxhetit të vitit 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Adnan Reka: Vendimin për transferimin e mjeteve buxhetore nga një program në një nën-program buxhetor me arsyetimin se, transferet e mjeteve buxhetore gati për çdo muaj konsiderojmë se janë një keq planifikim. Mungesa e arsyetimit me shkrim për shfuqizimin e

vendimit paraprak është jo transparencë, dhe vendimi i kuvendit për transferin e mjeteve buxhetore para lidhjes së një kontrate siç bëri kuvendi, është kundërligjor.

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është këtu, e ka sqaruar këtë çështje në KPF dhe e sqaron edhe këtu transferrin e këtyre mjeteve.

z. Betim Shala: Ne LDK mendojmë se është e paarsyeshme transferi i mjeteve 51214 nga projekti, ndërtimi dhe funksionalizimi i objektit të banimit social në vlerë prej 29,900€, ku shuma 20,000 € shkojnë në projektin me kod 50201 rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën urbane dhe rurale në Kaçanik. Ne mendojmë se duhet me punuar në ndërtimin e objektit të ri social të banimit, kur dihet se ende jemi brenda kontratës dhe ka ende pune me u kryer aty. Duhet të rritet dinamika e punës në këtë projekt e jo të hiqen mjetet nga ky projekt e të kalojnë në asfaltimin e rrugëve lokale.

z. Agim Çaka: Edhe unë pajtohem që sa me tepër të transferohen mjete, ka të bëjë me keq planifikim të mjeteve për projekte kapitale e sidomos tani kur merren mjetet nga një projekt i dështuar dhe transferohen në një projekt tjetër, që ka gjasa mos të realizohet as ky projekt. Ata që kanë lënë këtë bazë ligjore për transfer të mjeteve, i kanë menduar shpenzimin e mjeteve, në të kundërtën ishte bërë kaos. Sa ma shumë që transferohen mjete, të bënë me kuptuar se nuk po planifikohet e punohet mirë, se mund të jetë e kuptueshme kur del ndonjë diçka nga fatkeqësitë natyrore, munden me u marrë mjetet me u transferuar për shpenzim për raste emergjente, ndërkaq në këso raste ka diçka që nuk janë shpenzuar ato mjete dhe kjo del se nuk janë planifikuar mjetet mirë për këtë projekt dhe me i transferuar në një projekt tjetër, të i cili nuk është planifikuar me kohë.

z. Bashkim Krasniqi: Unë mendoj që ky transfer i mjeteve është i arsyeshëm dhe i ligjshëm, ndërkaq duhet përgëzuar drejtorin për angazhimin dhe vigjilencën e tij që po i transferon mjetet për shpenzim në ndonjë projekt tjetër, në mënyrë që mos të kthehen mjetet në suficit buxhetor.

z. Agim Mani: Nëse është në rregull ky transfer, atëherë pse na i keni sjellë këtë vendim me shfuqizuar vendimin paraprak. Ne kemi qenë kundër kur është marrë vendimi paraprak për transfer të mjeteve dhe kemi pasur plotësisht të drejtë. Arsyetimi nuk është më shkrim, kështu që presim arsyetimin e drejtorit.

z. Bahri Selimi: Ky është propozim vendimi i fundit për transfer të mjeteve buxhetore. Iu falënderoj për mbështetjen e tyre, sepse vendimet për transfere kanë ndikuar për realizim sa më të madh të buxhetit të komunës. Asnjë propozim vendim ne nuk i sjellim pa bazë ligjore, ju që jeni kundër besoj se nuk i lexoni, se vendimet bazohen në ligjin për vetëqeverisje lokale dhe ligjin për financat publike dhe përgjegjësitë si dhe ligjet tjera dhe rregulloret administrative. Vendimet pas miratimit i vlerëson organi shqyrtues- MEF. Nëse nuk janë në rregull, sigurisht i kthejnë prapa, por nuk i ka kthyer asnjëherë prapa dhe e mirëpret angazhimin e zyrtarëve të komunës që buxheti i komunës i qytetarëve të asaj komune të shpenzohet brenda vitit fiskal, 1 janar -31 dhjetor. Arsyeja e vetme pse është kthyer ky vendim, është së jemi në përfundim të vitit dhe po të ishte lidhur kontrata për këtë projekt në fillim të vitit, se ka dështuar disa herë për kundër kërkesave të organeve relevante, është data 19 tetor 2022 kur është lidhur kontrata, në vlerë mbi 400 mijë euro, ndërkaq mjete të planifikuara janë, 200 mijë sivjet, 200 mijë në vitin e ardhshëm. Kontrata është 2 vjeçare, pra kemi kursim, se nuk mundet komuna me planifikuar saktë sesa lidhet kontrata. Kemi 43,252€ nën buxhet të kontratës, dhe kjo është arsyeja që kemi bërë kërkesë për transfer se koha kur është lidhur kontrata, kushtet, atmosferike, dinamika e punës, nuk mjaftojnë që shuma 200 mijë euro me u shpenzuar sivjet. Për këtë arsye 15% e ndarjeve buxhetore apo shuma afërsisht 30 mijë euro mundet me u transferuar, dhe e kemi propozuar me u transferuar të rrugët lokale dhe për blerje të agregatit të kultura, se buxheti i komunës duhet shpenzohet drejt nevojave të qytetarëve e jo të kthehet

prapa. Paraprakisht ju keni pasur mundësi me ardhur edhe në zyre me pyetur për këtë transfer të mjeteve.

z. Adnan Reka: Sqarimet drejtor është dashur të jenë në propozim vendim, se tani janë me vonesë, se e keni obligim ligjor me i dhënë arsyetimet, e jo ne me ardhur ne në zyre me i marrë informatat.

z. Agim Mani: Faleminderit për sqarime. Me 29.04.2022 e keni hapur tenderin, vlera e parashikuar e tenderit është 490 mijë euro. Ofertuesit të cilët kanë ofertuar mbi vlerën e parashikuar që ju e keni parashikuar 450 mijë euro kanë qenë, 480 mijë euro dhe 470 mijë euro. Ju i dërgoni në OSHP sa të duash, me keqardhje e themi, është marre që të gjitha tenderët mos me dalë në favor të komunës, por në favor të OSHP. Kjo është shumë keq për komunën që po bimë në këtë nivel, ndërkaq tani po kërkon përsëri me i bartë mjetet në mënyrë jo ligjore

Kryesuesi i Kuvendit: Mjetet barten në formë të ligjshme, se asnjë cent nga ky KK nuk mund të bartet në formë të paligjshme, duhet ta keni parasysh këtë fakt, se është dikush që na vlerëson vendimin tonë, kështu që mos e keqinterpretoni këtë çështje. Me marrë vendim të paligjshëm, na kthehet prapa nga autoriteti mbikëqyrës-ministria.

z. Adnan Reka: Ne e kemi marrë një vendim të padrejtë ,sepse është marrë vendimi para tenderit, kjo nuk ka kuptim.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne jemi KK që kemi më së paku vendime të cilat na janë kthyer nga autoriteti mbikëqyrës si të paligjshme. Këtë mundesh me vërtetuar në raportin e MAPL për monitorimin e komunave.

z. Bahri Selimi: Për çdo informacion shtesë, mundeni me iu adresuar zyrës së prokurimit, ku shpallen tenderët dhe lidhen kontratat. Pasi të lidhet kontrata, ne bëjmë analiza për buxhetin e shpenzuar sa me lartë. Të kodi, furnizim me pajime ekzistojnë edhe pajimet nën vlerë 1000 euro, që cilësohen si investime kapitale për shkak të qëndrueshmërisë së tyre edhe ato nën 1000 euro që i përkasin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. 99 % e vendimeve që i kemi marrë, janë në pajtim me ligjet në fuqi, rregullore dhe UA, kjo është kthyer për çështje teknike e jo për ato ligjore. Meqë nuk po kemi rishqyrtim të buxhetit, atëherë po lindë nevoja për transfer të mjeteve për shpenzim sa me të madh të buxhetit, për këtë i falënderoj shumë për mirëkuptimin tuaj. Kohën e keni në dispozicion që secili propozim që vjen, me ardhur me kërkuar informacione shtesë.

z. Adnan Reka: Është në obligimin e juaj ligjor me na i ofruar të dhënat shtesë, e jo me ardhur ne në zyre e me i kërkuar. Mos kërkon nga anëtarët e KK që ne me ardhur në zyre me kërkuar informacione shtesë.

Kryesuesi i Kuvendit: Pjesa me e madhe e sqarimeve e vendimeve mund të epën në KK, se për cilindo propozim vendim anëtar i KK mundet me kërkuar sqarime shtesë, sepse mund të mos jenë sqarimet e mjaftueshme për secilin anëtar të KK. Ne duhet të diskutojmë në frymën komunikuese e jo në atë pikën se nuk ka sqarime të mjaftueshme shtesë.

z. Rrustem Zenuni: Ky vendim ka një arsye që ka ardhur këtu, se nuk kemi pasur rishikim të buxhetit të Republikës së Kosovës, kështu që ka lindur nevoja e transferit të mjeteve nga një projekt në tjetër, në formë ligjore, kështu që këto diskutime më duken jo të arsyeshme. Unë pse jam këtu, me kanë votuar qytetarët, pse kjo çështje na është adresuar, është në obligimin ligjor me miratuar.

znj. Ardita Rrahmani: Nëse ka qenë ligjor, atëherë pse ka nevojë vendimi me u ndryshuar, se po flasim për të njëjtin vendim, ndërkaq po e arsyetoni edhe kur është gabim dhe po thoni mirë është. Ndërkaq, pas një muaj ditësh na vjen vendimi me ndërruar dhe thoni së është ligjore me u ndryshuar vendimi.

z. Naim Beça: Sa i përket transparencës, ne anëtarët e KK nuk po marrim shumë informata qysh po thoni ju. Me pasur një TV, me mirë i kishim kuptuar çështjet, se ne po duhet me i studiuar, prandaj transparenca nuk është bash ashtu si e potenconi. Jepen sqarimet pse duhet me u bërë këto ndryshime, atëherë ne e votojmë, për atë është demokracia. Ne i kemi mendimet tona si LVV, pavarësisht a është i ligjshëm apo jo një çështje, ne nuk e shkelim ligjin nëse nuk e votojmë atë çështje, ndërkaq në aspektin njerëzor nuk jam kundër askujt. Ne i kemi mendimet tona, e drejta jonë është edhe me refuzuar.

z. Adnan Reka: Ju po doni për ndryshuar vendimin e datës 29.09.2022 për një shkelje që është bërë. Agimi e potencoj se vlera e parashikuar e kontratës është 490 mijë euro, ndërsa janë ndarë për projektin 450 mijë euro, dallimi është esencial, kjo nuk është në rregull.

z. Rrustem Zenuni: Desha të ndërlihem me diskutimin që tha që 20 vjet është në pushtet kjo qeveri. Qytetarët janë ata që kanë dashur me qenë në pushtet kjo qeveri. Unë iu kam nënshtruar një vlerësim të qytetarëve dhe na bazë të atij vlerësimi jam këtu.

z. Agim Çaka: Ne nuk mundemi t'i kuptojmë apo t'i dimë të gjitha çështjet, kështu mund të kërkojmë sqarime, nuk bënë me u revoltuar ne mes veti se duhet ruajtur aspektin njerëzor, ndërkaq në aspektin politik dallojmë. Ne si subjekte politike i kemi mendimet tona, pavarësisht a është mirë apo jo, unë edhe me herët e potencova se nuk është mirë me bërë shumë transfere, sepse kjo del se nuk janë bërë planifikimet e mira. Askush nuk e konteston që mjetet që mbesin, mos të shpenzohen diku tjetër dhe askush nuk jemi me shkelur ligjin. Esenca e krejt diskutimit është që planifikimi ka qenë i gabuar, mirëpo kur mjetet po i marrin nga një projekt dhe po i destinojmë në projektin tjetër, kjo të tregon se ai projekt ka mbetur anash, ndërkaq arsyet nuk i dimë, megjithatë nëse vendimi është ligjor duhet me kaluar, ndërkaq projektet kapitale ne duhet të angazhohemi që mos t'na dështojnë.

z. Selajdin Troni: Kur ka mundësi që mjetet mos me humbur, pse mos me u shpenzuar diku tjetër e mos me u kthye mjetet në qeveri. Nëse nuk blihet gjeneratori e mbetet objekti i kulturës pa rrymë, atëherë do të jepni vërejtje pse nuk keni bërë zgjidhje, kështu që më mirë është këto mjete me i ri-destinua si në propozim vendim, sesa me i kthyer në qeveri. Projekti i objektit të banimit social, nuk besoj se ka dështuar, por kushtet atmosferike janë ato që nuk mundet me punuar në këtë kohë, kështu që pse mos të shpenzohen mjetet aty ku ka nevoja tjera.

z. Naim Beça: Çështjet politike janë çështje politike, ndërkaq të çështja e gjeneratorit, çka na duhet ai gjenerator, se aty në atë sallë nuk bëjnë dritat, se pari duhet rregulluar dritat se nuk ka rrymë aty. Nëse bënë vetëm një komplet i dritave aty, "gjeneratorin e blej unë me paratë e mia".

z. Agim Mani: Desha me u ndërlihur me kolegun Zenuni për shprehjen që përdori, "po me shkon nerva". Unë e respektoj si ulëse në KK, ndërkaq unë kam menduar se kur të merr fjalën në kuvend anëtar i KK ka me kontribuar në çështje të caktuara, ndërkaq ky po bien në kundërshtim me vetveten, se ka votuar për çështjen, ndërkaq tani përsëri është për. Tjetër, drejtori tha se ne duhet me shkuar me i marrë informatat të prokurimi, unë i kam nxjerrë të dhënat nga prokurimi, unë mendoj se ju nuk jeni të harmonizuar sa duhet me prokurimin se nëse ju i harmonizoni qëndrimet, atëherë projektet shkojnë me mirë. Vlera e paraparë është 490 mijë euro, ndërsa vlera e kontratës është 450 mijë euro., po flas nga informatat zyrtare që i kam.

z. Bahri Selimi: A jeni në dijeni se në harmoni me ligjin të gjitha të institucionet e nivelit qendror çdo ditë bëjnë transfere se është nevojë, ndërkaq nivelit lokal nuk ia mundëson ligji ekzekutivit me bërë transfere, dhe ia adresojmë KK për aprovim, është e drejtë e juaja si i vlerësoni dhe a i votoni.

z. Adnan Reka: Mos u mundoni me na bindur për diçka që është e ditur, ju i keni ndarë 450 mijë euro për këtë projekt, ndërkaq vlera e parashikuar është 490 mijë euro. Potencialisht nuk keni mjete me paguar.

Kryesuesi i Kuvendit: Mos u mundo me keq informua, për secilin projekt parashikohet një vlerë e që asnjëherë në bazë të tregut që aplikojnë operatorët ekonomik, nuk del vlera që parashikohet. Nëse operatorë ekonomik ka ofertuar nën vlerën e parashikuar, çka ka të bëjë me çmim këtu. Nuk mundesh me lidhur kontratë, nëse nuk i kemi mjetet e zotuar, mos keq informo, është dashur me marrë kontratën me pa. Secili anëtar i KK mundet me u aktivizuar me ardhur në komunë me u konsultuar gjatë tërë muajit për secilën çështje dhe me bërë punë të mira si komunë, se nuk është vetëm kjo 1 ditë në muajt me qenë aktiv.

z. Adnan Reka: Unë nuk po pajtohem me ju drejtor që ne anëtarët e KK me ardhur në zyre e me marrë informata. Unë po kërkoj që informata të na dërgohet me shkrim përmes emailit zyrtar, se kjo është rruga që duhet ndjekur.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 14 votë Për (LDK, AAK), Kundër ish-in 10 (4 LDK dhe 6 LVV), Abstenoj Raif Kasa nga LVV dhe Agim Çaka nga NISMA. Pjesëmarrës në votim, 26. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për transferin e mjeteve sipas buxhetit të vitit 2022 / Lënda: 01Nr. 60/01-30764/22.

5. Propozim Vendimi për formimin e Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo është procedurë formale në fund të çdo viti që KK të formoj Komision për hartimin e planit të punës së KK përbëhet nga 5 anëtarë, 4 nga KK, Kryesimin e bëjë unë. mbetet të propozohen edhe 3 anëtarë nga KK. Nga Ekzekutivi është Zyrtarja e KK, Makfire Malsiu. Nuk prish pune nëse shtohet numri i anëtarëve edhe nga subjektet tjera politike. E hapi diskutimin: Nëse nuk ka kush diçka rreth kësaj pike, atëherë shkojmë me propozime konkrete:

z. Rustem Zenuni, Nga PDK e propozoj, Fatmir Bunjaku;

z. Adnan Reka nga LVV e propozojmë, Agim Mani.

z. Besnik Salihu, Nga LDK e propozojmë, Arlinda Rakoci-Raka.

Kryesuesi i Komisionit është Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, ndërkaq nga ekzekutivi i komunës është anëtare zyrtarja e KK, Makfire Malsiu.

Kryesuesi i Kuvendit: atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 24 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenoj Raif Kasa. Pjesëmarrës në votim, 25, për momentin nuk ishte në sallë Betim Shala. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023 në përbërje:

- | | | |
|------------------------|----------|----------------------|
| 1. Kemal Murseli, | kryesues | nga KK |
| 2. Fatmir Bunjaku | anëtar | nga KK |
| 3. Agim Mani | anëtar | nga KK |
| 4. Arlinda Rakoci-Raka | anëtar | nga KK |
| 5. Makfire Malsiu | anëtar | nga Zyra e Kryetarit |

Lënda: 01Nr. 60/01-30793/22.

6. Propozim Vendimi për shpalljen e interesit publik të pjesëve të PK 00431-3 dhe 00431-4 në ZK Duraj, për këmbim me pronën komunale 00430-1 ZK Duraj;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Ne në shumicën e rasteve i kemi kundërshtuar këmbimin e pronave për shkak të procedurave. Për këtë këmbim të propozuar, rruga është shtruar sivjet, tani na vjen propozimi. Fillimisht është dashur të kryhen procedurat paraprake, pastaj t'na vjen propozim vendimi. Nuk jemi ne kundër shpalljes së interesit për këmbim të pronave, por jemi kundër procedurave, se nuk është në rregull me u bërë kjo me një marrëveshje të noterizuar të noteri, pa pasur ndonjë marrëveshje tjetër.

z. Rrustem Zenuni: Rruga nuk është shtuar sivjet, por në vitin e kaluar. E dyta, pse ka ardhur ky këmbim, se ne si banorë të komunitetit kemi kërkuar të përfitojmë nga rasti dhe të zgjerojmë rrugën dhe kemi kërkuar nga pronari të gjej formën dhe procedurën dhe kjo është forma për me u zgjeruar rruga, këmbimi i pronave dhe këtë praktikë do ta ndjekim edhe në vazhdim aty ku ka interes edhe komuniteti.

z. Adnan Reka: Z. Rrustem, nga reagimi po duket se po i bien se ju ndoshta keni qenë sponsorizua i kësaj çështje. Besoj se edhe ju pajtoheni që paraprakisht me u kryer procedurat, pastaj me u shtruar rruga e jo e kundërta. Vendimi për këmbimin e pronës komunale me pronën private në ZK Duraj është i pa drejtë për faktin së, se pari ishte ndërtuar trotuari në pronë private e më pas u kërkua këmbimi i pronës. Prona publike përgjatë atij trotuari ishte e mjaftueshme për ndërtimin e tij (pjesa më e ngushtë 6m, pjesa më e gjerë 9.5), prandaj një gjë e tillë ishte fare e panevojshme

z. Rrustem Zenuni: Ne me vet iniciativë e kemi zgjeruar rrugën në vitin e kaluar, por kemi prekur shumë prona, dhe është arritur mirëkuptimi për këmbim të pronave dhe kjo ka ardhur në një moment të shpejtë, ndërkaq unë e kam potencuar çështjen e këmbimit, kam kërkuar buxhet të veçantë për çështje të këmbimit të pronave aty ku ka interes komuna se gjeodetet e komunës po e kanë të pamundur me i kryer krejt, kështu që kam kërkuar që përmes procedurave të prokurimit publik t'i epën këto çështje ndonjë kompanie dhe të rregullohen. A duhet me u kryer procedurat paraprake, normal që duhet, por një diçka që ka ndodhur, nuk mundemi me lënë pa e rregulluar. Rruga është 4 m. Çështja është se disa anëtarë të KK nuk iu interesojnë fare sesi jetojnë qytetarët, ju mundeni me ardhur e me i vizituar, se asnjëherë nuk i vizitoni veç kur janë zgjedhjet,

z. Adnan Reka: A mundesh me më treguar Rrustem ajo rrugë sa është e gjerë, nëse nuk e ke ditur e shikon tek drejtorja, se pika ku mendoni ju me shpronësuar për rrugë i ka 10m, nëse nuk e dinë shko të drejtori e sheh dhe përsëri po kërkon pronë për këtë rrugë. Është dashur me i shikuar ata që kanë dal në pronë publike dhe me shtruar trotuarin në pronë publike, e jo me shtruar paraprakisht trotuarin, pastaj me kërkuar këmbimin e pronave, kjo si procedurë nuk është në rregull.

z. Rrustem Zenuni: Rruga është 4 m. Çështja është se disa anëtarë të KK nuk iu interesojnë fare sesi jetojnë qytetarët, ti mundesh me ardhur e me i vizituar, se asnjëherë nuk i vizitoni veç kur janë zgjedhjet, të ka ardhur ne email e nuk e ke ditur. Kur të jesh i gatshëm shkojmë e shikojmë dhe shikojmë, nëse del se është 10 metra, unë do të votoj kundër.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse është përfillur kërkesa e komunitetit, nëse është pajtuar pronari me rregulluar këtë çështje, atëherë çka ka të keqe këtu. Nuk është mirë me na ndodhë, por kur po fillojnë me u ekzekutuar punimet, po i shohin defektet. Nëse komunës nuk paraqet problem ky këmbim, atëherë është e ligjshme me u bërë ky këmbim, për shkak se rregullohet traseja e rrugës më drejtë. 2. A është dashur me u bërë me herët, po është dashur, jo vetëm në këtë rast, por në të gjitha rastet, por çështja është pse nuk është paraparë me herët. Çështja se a ta lëmë

keq atë pjesë veç se nuk është paraparë me herët, nuk është në rregull, kështu që kurdo që një çështje mundet me u rregulluar në të mirë të qytetarëve, me vendime të KK, duhet me u rregulluar.

z. Adnan Reka: Rruga është ndërtua në pronë private, emri i rrugës është “Hetem Hasaj” e jo “Avdyl Dura”, gabimet po i bëni jo pa qëllim.

z. Selajdi Troni: Nuk e di pse po debatoni në këtë formë. Kur pronari është i pajtimit me rregulluar këtë çështje që është në të mirë të komunitetit, atëherë pse mos me rregulluar, sepse forma e debatit nuk është e mirë. Nëse nuk doni me votuar nuk e voton, na po e shohim së kjo çështje është në interes të qytetarit, atëherë pse mos me votuar.

z. Adnan Reka: Unë i kam qëndrimet e mia dhe nuk kam nevojë për këshillat e juaja. Mundem me u pajtuar apo, këshilla nuk ka nevojë me më këshilluar. Unë jam duke i dhënë propozimet e mia, unë i kam mendimet e mia dhe nuk ka nevojë me më u bërë avokat, ju jeni me drejtuar seancën.

z. Naim Beça: Askush nuk është kundër qytetarëve, por çështja është mos të debatojmë në këtë formë. Na e tregoni praktikisht skemën përmes TV, atëherë e shikojmë se qysh po i vjen, se çështja është ne nuk po mundemi me gjetur se ku është prona e këtij pronari. Qysh me votuar ne këtë këmbim, kur kemi mungesë të informacioneve.

z. Rrustem Zenuni: Për me i ditur pronat ku janë, duhet me pa vet, se këshillat që i ke marrë nga të tjerët janë të gabuara. Nëse janë 10 m aty qysh po thoni, unë jam në gjendje me lënë pozitën e anëtarit të KK, por unë e di se nuk iu interesojnë interesat e qytetarëve.

z. Qamil Stagova: Sqaroj se nga pronari Fehmi Fazliu janë marrë 1 ari e 21m², ndërkaq nga prona publike këmben me po të njëjtën sipërfaqe 1 ari e 21m² dhe ky këmbim është në interes të përgjithshëm të qytetarëve të atij komuniteti. Sa për fjalorin që po përdoret, duhet me folur pa pasur argumente.

z. Adnan Reka: Unë e kam një kërkesë për DUKMM: A ka mundësi në mbledhjen tjetër me na i sjellë gjatësinë e parcelave të pronës private me pronën publike (pjesa ku këmben pronat), ku është ndërtuar rruga dhe me na i sjellë si dokument.

z. Rrustem Zenuni: Nëse nuk del gjatësia e pronës private 10 metra, ju keni me lënë pozitën e anëtarit të KK.

z. Adnan Reka: Unë zotimet e mia i bëjë vet, ndërkaq ti i vet i potencova zotimet e tua.

z. Qamil Stagova: Unë i sjellë dokumentet nëse i kërkon për qëllime serioze, ndërkaq nëse i kërkon për qëllime tjera, nuk i sjelli.

Kryesuesi i Kuvendit: Mundesh me shikuar Adnan në kadastër, drejtori e ka sjellë skicën këtu. Nëse iu intereson në aspektin funksional në rregull, nëse të intereson për diçka tjetër, atëherë nuk është në rregull.

z. Adnan Reka: Në aspektin funksional me intereson. Ju po thoni kërkon dokumente publike dhe po kërkojmë. Këtu shihet sesa është transparente komuna.

z. Besnik Salihu: Mbledhja është duke u transmetuar drejtpërdrejtë, jeni duke zhvilluar debate të panevojshme. Ne si LDK do të votojmë Për, sepse në atë pjesë ka nevojë për trotuar. Pajtohem me kryesuesin që tha se aty është një lloj kthese dhe duhet me u rregulluar, është e nevojshme me u shpronësuar. Aty afër është busti i heroit Hajredin Fazliu që e madhështon atë pjesë.

z. Agim Çaka: Drejtor, edhe unë jam me u bërë matjet dhe me na i sjellë këtu skicat, jo për qëllim që u potencua. Nëse është pëlqimi i komunitetit dhe është nevojë me u bërë ky këmbim,

nëse ka ndonjë ankesë nga komuniteti se komuna po bënë shkelje, atëherë kishte pasur nevojë me diskutuar këtu, mirëpo ankesa nuk ka pasur, projekti është në të mirën e komunitetit, kështu që kur të dal çështja në votim, unë do të votoj Për.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 18 votë Për (PDK, LDK, AAK, NISMA), Kundër ishin 6 anëtarë të LVV, Abstenoj Raif Kasa -LVV. Pjesëmarrës në votim, 26 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shpalljen e interesit publik të pjesëve të PK 00431-3 dhe 00431-4 në ZK Duraj, për këmbim me pronën komunale 00430-1 ZK Duraj / Lënda: 01Nr. 06-941/01-30878/22.

7. Diskutim për aktivitetet kundër dhunës në baza gjinore;

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo pikë është propozuar në KPF me qenë në rend pune në këtë mbledhje nga znj. Kadrije Lika-Troni, ia japim fjalën fillimisht.

Kadrije Lika-Troni: Falënderojmë anëtarët e KPF që u pajtuan të kërkesa e LVV të shtohet kjo pikë për diskutim në mbledhje të KK lidhur me fushatën 16 ditë aktivizëm në baza gjinore. Thuhet se dhuna nuk njih moshë, nuk njih gjini, por dhuna po njih gjininë, sepse pikërisht kur me datën 25 nëntor hapet fushata 16 ditë aktivizëm kundër dhunës në baza gjinore, pikërisht jemi 1 me pak, se atë ditë ndodhi një viktimitë grua nga bashkëshorti i saj. Në këto 16 aktivizëm, do të bëjmë me tepër që zëri ynë të dëgjohet e të mbërrijnë të çdo grua në çdo cep të vendit, për të mundësuar që gratë dhe vajzat të mbështetën me shumë, përpjekjet tona nuk duhet ndalur 365 ditë të vitit për të luftuar dhe parandaluar dhunën ndaj grave dhe vajzave. Dhuna në baza gjinore është instrument i rrënjosur thellë në pabarazinë gjinore dhe vazhdon të jetë një ndër shkeljet me të dukshme të drejtave të njeriut në të gjithë shoqërinë. Dhuna në baza gjinore është dhunë e drejtuar ndaj 1 personi për shkak të gjinisë. Edhe gratë edhe burrat po përjetojnë dhunë në baza gjinore, por shumica e viktimave janë gra dhe vajza. Sipas statistikave të Republikës së Kosovës, vetëm 2% e rasteve raportohen si raste të dhunës në familje, ashtu që nga janari –deri në fund të muajit nëntor të këtij viti në nivel qendror kemi 2364 raste të raportuara, ndërsa në komunën tonë sipas raporteve në 4 vitet e fundit, 2019 -24 raste, 2020 - 16 raste, 2021-29 raste, 2022- deri në fund të nëntorit 24 raste. Në komunën tonë është shqetësuese sipas informatave që kemi, se nuk ekziston asnjë organizatë që merret me aktivitete për sigurinë dhe fuqizim të grave e vajzave në të gjitha lëmit e tyre dhe përfaqësimin e tyre në shoqërinë tonë. Unë në seancën e kaluar kam kërkuar që komuna të ndërtoj një strehimore për rastet e dhunës në familje. Deri me tani komuna nuk ka marrë asnjë iniciativë, besoj tani e tutje nga formimi i grupit të grave asambleiste në kuadër të komunës, shumë punë dhe procese t'i shtyjnë përpara sa i përket fuqizimit të grave, sepse deri tani nuk është se ka pasur iniciativa me rezultate të dukshme në këtë drejtim. Për fund, edhe me konventa ndërkombëtare, siç është konventa e Stambollit, është detyrë dhe përgjegjësi e secilit prej neve të marrim guxim dhe t'i raportojmë raste që i shohim dhe i dëgjojmë, si dhe të punojmë bashkërisht në senzibilizimin dhe ndërgjegjësimin e opinionit në lidhje me dhunën në familje, duke nxjerrë nga elementi i privates, ti paraqesim të organet përgjegjëse, kështu rrisim masën e parandalimit të rasteve me përfundime fatale për familje dhe shoqërinë tonë. Kam thirrje të përgjithshme; "Raporto dhunën në familje dhe jepi fund heshtjes".

Kam një kërkesë , të çështja e formimit të komisionit të ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, meqë jemi në fushatë kundër dhunës në baza gjinore, kam vërejtur se është bërë shkelje, se komisioni nuk ka përfaqësim gjinore, me çka është bërë diskriminim gjinor në këtë rast, sepse të gjithë anëtarët-5 sish janë meshkuj (i lexoj emrat e komisionit të ankesave).

Kërkoj që të merren veprime të nevojshme për ndryshimin e vendimit, ashtu që të përfshihet në këtë komision edhe anëtare femra.

znj. Ardita Rrahmani: E ndiej për obligim dhe vejë në theks se kjo çka do të diskutoj tani, iu drejtohet të gjithë burrave të pranishëm në këtë sallë. Pse burrave, mundeni me pyetur ndokush nga ju, me të drejtë apo pa të drejtë? Burrave, sepse të kota janë ato tryeza rrumbullakët në të cilat shterët diskursi rreth dhunës në baza gjinore, e ku 99% janë aty gra, e mu ata që e shkaktojnë këtë problem nuk janë të ulur. Po iu drejtohem burrave, sepse thirrja për ndërgjegjësim të dhunës të cilësdo forme të ushtruar, vjen kryesisht nga ta. Burrave, sepse në të shumtën e rasteve janë këta shkaktarë të organizimeve e debateve të tilla, pas së cilave nxirren konkludime e rekomandime, e që në praktikë vazhdojnë të veprojnë sikurse nuk po ndodhë asgjë. Prandaj, po iu drejtohem burrave. Për ironi të fatit, bash në ditën kur nisë zyrtarisht fushata e senzibilizimit të dhunës në baza gjinore, në mëngjesin e hershëm të asaj dite të zezë të individit dhe familjes, një femre, nënë, grua e emancipuar- profesoreshë, i merret jeta në mënyrë me mizore në kryeqytet pikërisht nga një burrë, nga një burrë që ndër vite e kishte ushqyer, pastruar, ndarë momentet me të lumtura me të, pikërisht nga një burrë që ishte rrezikuar dhe falë gjithë jetën figurativisht, besa edhe në praktikë, pikërisht nga ai burrë u ekzekutua. Rastet si ky, përveç që të ftoh in rrobat në trup, duhet të jenë thirrje dhe hapur veshët për secilin burrë që ka një femër prezentë në jetën e tij, qoftë nënë, grua, motër, e dashur apo vajzë. Kisha fati e mirë që ditë me parë të isha pjesë e delagacionit e UN Women dhe drejtoreshën për Republikën e Kosovës të kësaj organizate Vlora Nushi-Duzi, në të cilin takim u diskutua se sa e habitshme dhe e frikshme është rritja e rasteve të dhunës së grave që janë pjesë e jetës publike dhe asaj politike. Në një raport të nxjerrë së fundmi nga UN Women thuhet se, në çdo orë vriten 5 gra apo vajza në botë. Kjo është e frikshme dhe ky trend fatkeqësisht po na përcjellë edhe ne si shtet në atë rrugë. Kur kjo dhunë ndodhë edhe të ato gra që për disa të tjera mund të jenë inspirim për rezistencë dhe qëndresë dhe arritje, atëherë edhe me i dhimbshëm është ky realitet virtual i paraqitur. Uroj që thirrjeve për ndërgjegjësim të dhunës t'iu bashkohen fillimisht burrat dhe djemtë e rinjë për t'iu dhënë shtytje edhe me shumë ngulm edhe nga gratë dhe vajzat. Rastet e dhunës në baza gjinore ndodhin edhe ndaj burrave, e që nuk janë të rralla, e aspak për të duartrokitur dhe lënë në harresë për me u përmendur. Është për keqardhje sesi asnjë rast sado tragjik të jetë, nuk shkon as tri ditë burgimi e diskutimi, pastaj përfundon si rrjedhojë se ligji sado që është në letër, nuk ka qenë efikas dhe i zbatueshëm në praktikë. Dhunën nuk ndalur me arsyetim e tillë se jemi gra apo femra, por se jemi qenie njerëzore të barabarta si burrat. Uroj që edhe komuna jonë t'iu dal në krah personave të prekur, dhe të kemi një zingjir bashkëpunimi me QPS, Policinë e Republikës së Kosovës dhe qytetarët. Po ashtu, bëjë thirrje dhe pres që këtë vit të kemi edhe ndonjë aktivitet për solidarizim dhe shënim të këtyre ditëve të aktivizimit.

Kryesuesi i Kuvendit: Të gjithë ne se bashku edhe ne burrat, sepse po e shoh se burrat po hezitojnë me folur, duhet me folur dhe pajtohem me gjithë atë që u tha nga dy koleget, duke marrë parasysh rolin e femrës në shoqërinë tonë Kosovare e shqiptare ka qenë i jashtëzakonshëm në periudha të ndryshme, marrë parasysh kohën e fundit të luftës në Kosovë. Duhet çmojmë lartë kontributin e nënave e motrave tona që dhanë kontributin e pashlyer në histori gjatë kohës së luftës duke ushqyer dhe duke kujdesur për fëmijët edhe nëpër tenda dhe në të gjitha rreziqet. Ne duhet të jemi vet iniciatorë të dënimit të dhunës në familje e cila u cek edhe me herët, marrjen e jetës së një mësuesja nga bashkëshorti i saj, që nuk i dimë arsyet dhe nuk ka asnjë arsye t'iu merret jeta dikujt. Bashkërisht duhet dënojmë të gjitha aktet çfarëdo qofshin ato. Përveç kësaj, ne duhet përkushtohemi këtyre çështjeve në diapazon me të gjatë. Duhet të hartojmë strategji për avancimin e femrave në shoqërinë tonë. Është e mirë dhe e

drejtë e secilit qenë kërkoj që edhe femrat të jenë bashkëpronare të pronave, dhe veprimtari e aktivitete tjera që femra me i zhvilluar aktivitetet e saj. Ka shumë veprimtari dhe dukuri tjera që përveç dhunës, mund të bëhet avancimi i femrës në pozita të ndryshme. Të komisioni i ankesave, ne i kemi mundësitë me ndryshuar vendimin, ndërkaq sa i përket dhunës, organet duhet të jenë me vigjilente dhe të marrin masa me të rrepta ndaj atyre veprimeve të kundërligjshme që merren ndaj femrës, se në shumtën e rasteve këto organe po janë neglizhencë dhe po ndodhin rastet. Ajo që na përket ne, se paku si KK dhe si komunë, me kompetencat që kemi t'i trajtojmë njësoj dy gjinitë. Ne kur u formua komisioni i ankesave, kemi pasur mundësi me pasur përfaqësim në këtë komision ndonjë femër nga KK apo nga ekzekutivi. Në mundësitë që i kemi ne, përpos strategjisë dhe planit që mund t'i hartojmë, të cilat dokumente mund të ndikojnë në luftimin e kësaj dukurie negative, më kompetente mund të jetë organet e sigurisë -policia që duhet të jetë syçelë në të gjitha rastet kur ushtrohet dhunë ndaj një femre se pastaj rastet po shkojnë në fatalitet. Zyrtari për barazi gjinore-Vedati nuk qenka këtu, por nga informacionet që kam, në të gjitha xhamitë është trajtuar tema e dhunës ndaj gruas, kështu që ne po mundohemi aty ku ka mundësi t'i trajtojmë ato tema, megjithatë organet kompetente duhet të jenë me vigjilente në trajtimin e çështjeve të dhunës në baza gjinore, në mënyrë që të kemi sa me pak raste të tilla se si shoqëri. Rastet e tilla ndodhin edhe në vendet me të zhvilluara, ndërkaq ne si popull i dalë nga lufta, kemi vuajtur shumë, bashkërisht me ne kanë vuajtur edhe nënat dhe motrat tona.

z. Adnan Reka: Nuk po ndalem në komente, se të gjitha ato që u thatë janë të vërteta, por unë shpesh herë po i shoh si deklarata boshe, pa një vendim konkret në KK. Ne, në vend se me qenë shembull në KK, ne vet këtu po i shkelim rregullat themelore, në vend se të jemi shembull për të tjerët. Vendimi për formimin e komisionit të ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, mundem me ndryshuar tani dhe me u anëtarësua ndonjë femër në këtë komision, kështu që në aspektin simbolik mos të mbetet vetëm deklaratë boshe, por të veprojmë.

z. Agim Çaka: Është e vërtetë ajo çka u tha, se dhuna si dhunë është e papranueshme nga kushdo që vjen. Ne kohëve të fundit jemi dëshmitarë se ka pasur raste të dhunës të burrit ndaj gruas dhe të ngjashme si dhunë të gruas ndaj gruas, profesorit ndaj nxënësit, motrës ndaj fëmijës në çerdhe, doktori ndaj pacientit. Raste janë shqetësuese ndaj neve si shoqëri, ndërkaq me këtë fenomen duhet me u marrë të gjithë së bashku seriozisht, me organizimin e takimeve të ndryshme, manifestimeve të ndryshme të cilat kanë për qëllim të përbashkët angazhimin tonë kundër dhunës në baza gjinore. Dhuna është e papranueshme, e që mund të jenë si pasojë e luftës, Covid-19, të cilat shpjegohen në aspektin mjekësor, megjithatë janë raste evidente të cilat po ndodhin dhe po i shohim çdo ditë. Nuk ka nevojë këtu një grua apo një asambleiste me ngritë çështjen, që ajo të mbrojë vetveten. Ne duhet si shoqëri të gjithë se bashku që dhunën si dhunë me përjashtuar si koncept dhe si akt, dhe mos të mbetet veç asambleistja me kërkuar mbrojtjen e grave nga dhuna në baza gjinore. Rastet të cilat po ndodhin, ne duhet me na shqetësuar dhe duhet shqyrtuar problemin pse po ndodhin këto raste, sepse pasojat po janë fatale, sepse si popull nuk na kanë hije këto fenomene që po ndodhin. Unë jam për dënimin e tyre kushdo që merr iniciativë me dal në mbrojtje secilit që ushtrohet dhunë. Të çështja e komisionit, kjo është e rregulluar me ligjin për barazi gjinore dhe kjo duhet me u respektuar.

znj. Ardita Rrahmani: Në emër të grupit jo formal të grave asambleiste, e përkrahim propozimin e znj. Kadrije Lika-Troni për ndryshim plotësimin e vendimit të komisionit të ankesave për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale. Kjo çështje kërkoj të jetë në rend pune në mbledhjen vijuese të KK, kur dihet se në komisionin vlerësues janë të përfaqësuara 2 femra, ndërsa në atë të ankesave, asnjë femër.

Kryesuesi i Kuvendit: Në mbledhjen vijuese të KK do të ndryshohet dhe plotësohet komisioni i ankesave, ndërkaq komisioni i ankesave që është i formuar duhet t'i kryej lëndët të cilat janë në proces, sepse duhet të kemi propozim vendimin, për shkak se kalon afati ankesave për shqyrtim.

z. Adnan Reka: Unë nuk mundem me marrë pjesë në komisionin e ankesave përderisa jemi duke propozuar me ndryshuar komisionin, sepse pasi të kryhen lëndët, nuk ka nevojë me u ndryshuar komisioni dhe duhet respektuar të drejtat e grave. Komisioni mundet me pushuar aktivitetin deri me ndryshim plotësimin e tij.

Kryesuesi i Kuvendit: Komisioni vlerësues ndryshon, ndërkaq komisioni i ankesave e ka mandatin 2 vjet. Komisioni nuk mundet me pushuar aktivitetin, se janë afatet e përcaktuara të shqyrtimit të ankesave. Për mbledhjen vijuese, na vjen propozim vendimi për ndryshim plotësimin e komisionit të ankesave, ndërkaq komisioni aktual vazhdon punën deri me ndryshimin e vendimit.

z. Adnan Reka: Unë publikisht po e themi në shenjë proteste, se nuk do të marrë pjesë në komisionin e ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, pa u ndryshuar dhe plotësuar vendimi për formimin e këtij komisioni, ndërkaq pasi të ndryshohet vendimi, do të marrë pjesë.

Kryesuesi i Kuvendit: Është e drejtë e juaj a merr pjesë apo jo në komision për të cilin keni shprehur vullneti me qenë anëtar dhe vendimi ka dal në votim. Këto vërejtje keni pasur mundësi me i dhënë kur është formuar komisioni. Ne, tani duhet të presim procedurën e rregullt ligjore me ndryshuar vendimin. Lëndët janë në proces të komisionit të ankesave, në momentin që nuk shqyrtohen, bëhen të plotfuqishme.

z. Rrustem Zenuni: Ne si grup parlamentar i PDK e përkrahim propozimin e juaj që komisioni i ankesave t'i përfundoj lëndët që janë në proces, pastaj në vitin vijues e ndryshojmë dhe plotësojmë vendimin për formimin e ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale.

Kryesuesi i Kuvendit: Për mos me u neglizhuar puna, komisioni i ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale do të ndryshohet dhe plotësohet pasi të përfundojnë shqyrtimin e ankesave, se nëse ne e shfuqizojmë atë vendim, mbetet procedura në gjysmë e ankesave. Raporti i femrave në KK është 30% dhe ne nuk po kemi mundësi nga me pasur femra në secilin komision.

znj. Kadrije Lika Troni: Nga ekzekutivi i komunës ka femra drejtoresha, janë 2 femra që mundën me qenë anëtare në komision e ankesave.

Kryetari i Komunës: Komisioni me u ndryshuar dhe plotësuar miratimin duhet me marrë në kuvend, qoftë edhe me anëtarë nga ekzekutivi. Nëse komisioni i ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale ka ankesa të adresuar, duhet me i shqyrtuar se ankesave iu kalon afati ligjor.

Kryesuesi i Kuvendit: E konstatoj mbledhjen të përfunduar në ora 13:35. Deri në fund të mbledhjes qëndruan anëtarë 24 anëtarë, pasi që Betim Shala dhe Rabije Sallahi me arsye dolën nga mbledhja gjatë shqyrtimit të në pikës së fundit.

Procesmbajtëse

Makfire Malsiu

Malsiu



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);

**Nga Mbledhja e XI (njëmbëdhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës
për vitin 2022, mbajtur me 30.11.2022:**

1. Kemal Murseli,
2. Brahim Imishti.....,
3. Hamide Luma,
4. Kadri Krivenjeva,
5. Fitore Vishi,.....,
6. Rustem Zenuni,.....,
7. Edon Baftiu,
8. Selajdin Troni,
9. Fatmir Bunjaku,
10. Bashkim Krasniqi,
11. Florina Lika-Vishi,
12. Lejla Muhaxheri-Çaka.....,
13. Agim Mani,
14. Kadrije Lika-Troni,
15. Adnan Reka,
16. Naim Beça,
17. Raif Kasa,
18. Ernesta Krasniqi,.....,
19. Bashkim Luma,
20. Arta Avdiu,
21. Ardita Rrahmani,
22. Besnik Salihu,
23. Betim Shala,.....,
24. Arlinda Rakoci-Raka.....,
25. Rabije Sallahi.....,
26. Ekrem Livoreka.....,
27. Agim Çaka.....



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 23.12. 2022

Për: Anëtarët e Kuvendit:

z. Naim Beça,
z. Agim Mani,
z. Bashkim Luma
z. Bashkim Krasniqi

Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtuara para Kuvendit të Komunës, më datë 30. 11. 2022, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

z. Naim Beça:

Zotëri kryetar, drejtorët ndoshta të kanë thënë se i kanë rregulluar dritat, kanalizimet, por kjo nuk është e vërtetë, për shkak se gjatë të reshurave atmosferike, gypat e kanalizimeve nuk kanë funksionuar në rrugën “Emin Duraku” dhe të Stacioni i trenit. Duhet drejtoritë të dalin në terren të shikojnë gjendjen, në atë pjesë së nuk ka as drita janë projekte të thjeshta, por të ne ende nuk funksionojnë. Kërkoj të merren veprime të nevojshme nga organet relevante, sepse me mirë ka qenë gjendja me herët kur rruga ka qenë e pashtuar se tani, sepse uji gjatë të reshurave atmosferike qarkullon nëpër rrugë.

- *Mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik e bëjmë përmes kompanisë së kontraktuar. Aktualisht jemi në pritje të lidhjes së kontratës së re për periudhën 2 vjeçare, ku më pas do të intervenohet në të gjitha rrjetet ku janë të evidentuara defekte nga zyrtarët përgjegjes të drejtorisë nga vizitat në teren apo përmes raportimeve të qytetarëve.*
- *Kurse rreth daljes së ujit nga pusetat e rrjetit të kanalizimit fekal kur ka të reshura atmosferike është si pasojë e futjes së ulluqeve të kulmeve të shtëpive individuale në rrjet të kanalizimi fekal e ku dimenzionimi i gypave nuk i përballon këto ujra dhe njëherit edhe nuk janë të lejuara të zbrazen në këtë rrjet.*
- *Mirëmbajtjen e rrjetit dhe pastrimin e pusetave të kanalizimit atmosferik komuna e kryen në vazhdimësi përmes kompanisë së kontraktuar për mirëmbajtjen e rrjeteve të kanalizimeve atmosferike kurse, në lokalitetet ku KRU”Bifurkacioni” menaxhon me rrjetin e ujësjellësit, është e obliguar të bëjë edhe mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit fekal.*

z. Agim Mani: Pyetje për kryetarin e komunës-Besim Ilazi, lidhur me projektin e grumbullimit dhe furnizimin e ujit në rrjetin sekondar që do të zgjidhte problemin e ujit në shumë lokalitete, projektit me madhor që kushton mbi 1 milion euro, i financuar nga ministria, që është realizuar në komunën tonë gjatë mandatit të juaj kryetar. Edhe pse kanë kaluar shumë vite, ky projekt, nuk është përfunduar. Pyetja: Në cilën fazë është projekti dhe a keni arritur që këtë projekt të shfrytëzoni maksimalisht apo fare hiq, kur dihet se ky investim është mirëpritur nga qytetarët e komunës dhe ka qenë projekt shumë i nevojshëm me zgjidhë problemin e ujit në disa lokalitete dhe ka qenë investim i ministrisë për me zgjidhur këtë problem parësor qenësor. A keni arritur me bërë funksional dhe sa ka ndikuar që ky projekt me shtuar kapacitetin e ujit dhe sa është shtuar kapaciteti i ujit dhe a keni kërkuar ndonjëherë raport nga dikasteri përkatës lidhur me këtë projekt sesa është shtuar kapaciteti i ujit ?

- *Projekti “Sanimi , rekonstruimi dhe shtimi i kapaciteteve të ujit në rrjetin ekzistues të ujësjellësit për fshatrat Dubravë, Doganaj, Elezaj, Rekë dhe Nikaj” i financuar dhe mbikëqyrur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (ish MMPH-ja), është finalizuar sipas projektit të detajuar. Pas përfundimit të projektit i tërë rrjeti ka kaluar në menaxhim të KRU”Bifurkacioni”, kompani e liqencuar për menaxhim dhe mirëmbajtje të ujësjellësit. Në dy vitet e fundit edhe me buxhet komunal është intervenuar në kaptim të burimeve shtesë dhe shtim të kapacitetit të ujit. Aktualisht në këto lokalitete është zgjidhur problemi me furnizim të rregullt me ujë të pijshëm, janë vendosur ujëmatësit, dhe shumë shpejtë do të fillohet edhe faturimin e konsumatoreve nga kompania KRU “Bifurkacioni”.*

z. Bashkim Luma: Arsyet që unë sot para jush po e marr fjalën janë të ndryshme, duke filluar nga ndriçimi publik në fshatin Gllloboçicë, ku përveçse i parcializuar edhe pse tashmë bëhet një vit që nga fillimi i saj, tashmë si projekt është jo efikas sepse afërsisht 50 % e këtij gjysmë projekti ka kohë që nuk është funksional, arsyeja pse nuk është funksional duhet që të na tregoj drejtori përgjegjës për këto çështje. Përveç kësaj kërkoj që në emailin zyrtar të më dërgohet ky gjysmë-projekt i ndriçimit publik, por edhe projekti për renovimin e rrjetit të kanalizimit, si dhe projektin e ujësjellësit po ashtu të lënë në gjysmë, pra bëhet fjalë për projekte të fshatit Gllloboçicë, sepse mendoj që banorët e asaj pjese kanë nevojë të dinë më shumë për të vërtetat e secilit projekt!

- *Shtrirja e rrjetit të ndriçimit publik në fshatin Gllloboçicë është bërë në segmentet rrugore që janë me prioritet. Rrugët sekondare nuk janë prioritare para përfundimit të të gjitha rrugëve primare të fshatrave të komunës sonë.*
- *Mirëmbajtja e ndriçimit publik bëhen në vazhdimësi përmes kompanisë së kontraktuar. Aktualisht jemi në pritje të lidhjes së kontratës së re për periudhën 2 vjeçare, ku më pas do të intervenohet në të gjitha rrjetet ku janë të evidentuara defekte nga zyrtarët përgjegjës të drejtorisë.*
- *Projekti i rehabilitimit të rrjetit të kanalizimit dhe projekti i shtimit të kapacitetit të ujit për rrjetin ekzistues të fshatit Gllloboçicë janë të finalizuara dhe këshilltarët komunal do të mund të informohen për çdo projekt në Raportin Vjetor Financiar për vitin 2022.*

z. Bashkim Luma Dhe tjetra që po ashtu është shumë me rëndësi, ka të bëjë me kompaninë “KRM- Pastërtia” mua si komisionar i kësaj kompanie, së fundi më është dërguar një email nga


ish kryesuesi i bordit të drejtorëve të kësaj kompanie z. Skender Hyseni, po e ritheksoj ish kryesues sepse tashmë personi në fjalë është shkarkuar nga pozita e bordit të drejtorëve. Indikacionet sipas tij janë shkak që ai ka paraqitur pakënaqësitë e tij në keq menaxhimin e kompanisë. Sipas raportit 6 mujorë të këtij viti kjo kompani ka performuar me bilanc negativ, ashtu që inkasimi apo te hyrat e mbledhura janë më të vogla për 96,876.63€ sesa shpenzimet, (pra kemi një humbje prej afro 100 mijë €). Numër i madh i te punësuarve vetëm në këtë 6 mujor është afro 40 persona (e shumica në administratë). Besoj që ekzekutivi është i informuar për këtë humbje të madhe në kompaninë që edhe është komunale, por ne si kuvend ende s'kemi ndonjë sqarim lidhje me këtë situatë që me shumë të drejtë do ta quaja gjakderdhje financiare, andaj pa humbur kohë kërkoj nga ekzekutivi që të sqarohen për këto humbje kaq të mëdha të kompanisë për vetëm për 6 muaj.

- *KRM "Pastërtia"-sh.a Ferizaj është ndërmarrje regjionale ku edhe komuna e Kaçanikut është aksionare. Njësia Operative e Kaçanikut aktualisht është duke vepruar me formën e decentralimit financiarë nga Ferizaji dhe menaxhon me të hyrat dhe shpenzimet e veta. Si njësi e Kaçanikut ka stabilitet financiar dhe kryen me kohë të gjitha pagesat dhe shpenzimet e operimit. Poashtu edhe shërbimi i grumbullimit të mbeturinave në zonat e shërbimit kryhet me kohë. Si pjesë e fondit 279,433.00€, të përfutur nga komuna në Garën për Mjedis të Pastër për tri vite radhazi, njësia e Kaçanikut është paisur me (2) dy automjete të reja (1 kamion 16 m³ dhe 1 kamion 8m³) dhe pashtu janë sjellur donacion edhe (2) dy kamion të rinj me kapacitet 8m³ nga JICA-japoneze. Poashtu edhe rishikimi i tarifës së grumbullimit të mbeturinave nga kuvendi komunal do të ketë impakt të dukshëm në qëndrueshmëri financiare. Shumë shpejt kjo njësi do të pajiset edhe më 2(dy) automjete tjera të reja [(1) një kamion 5m³ dhe (1) një kamionetë 2.5m³]. Referimi juaj rreth opinionit të një ish-anëtari të Bordit të kësaj ndërmarrje për gjendjen aktuale financiare dhe menaxheriale të KRM"Pastërtia" sh.a Ferizaj besojmë se do të diskutohet dhe sqarohet në Raportin Vjetor Financiar 2022 dhe në takimin vjetor të Aksionarëve dhe Bordit Drejtues të kësaj ndërmarrje.*

z. Bashkim Krasniqi: Shprehi shqetësim lidhur me punëtorët të cilët punojnë në Ferizaj, se kanë mungesë transport deri të Fusha e Pajtimit. Kërkoj të shqyrtohet mundësia që se paku në mëngjes të sigurohet transport, sepse ka edhe nxënës që mësojnë në Ferizaj dhe transporti paraqet problem për ta, sepse po duhet me bërë shumë kilometra në këmbë deri të Fusha e Pajtimit.

- *Vërtetimi i Rendit të Udhëtimit për Operatorët e transportit të udhëtarëve bëhet çdo fillim të vitit duke rrespektuar Rregulloren Komunale për Transportin Rrugor në komunën e Kaçanikut. Ne do ta analizojmë propozimin dhe shqetësimin e juaj dhe në koordinim me operatorët e transportit të udhëtarëve që kanë rend të udhëtimit në linjën Begracë-Kaçanik i Vjetër-Kaçanik, të shqyrtohet mundësia dhe arsyeshmëria e shtimit të vijës së mëngjesit për transportin e udhëtarëve.*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!


Ramadush Osmani
Drejtor i DSHPE-së